

14.08.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbim i dizajnit, redaktim gjuhësor dhe printim i botimeve, për nevojat e Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Printime dhe shërbime të lidhura 79800000-2

Shërbime printimi 79810000-5

Shërbime të dizajnit grafik 79822500-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,466,850 (tre milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon pajisjet e nevojshme sipas specifikimeve teknike për zbatimin e kontratës, të pakën keto pajisje të mëposhtëme :

- pajisje për printim me ngjyra dhe bardhë e zi;
- pajisje për prerje të materialeve të shtypura;
- pajisje për plastifikim;
- pajisje për lidhje me ngjitje, kapje dhe/ose spirale;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet deklarate ku të cilesohet prodhuesi i paisjeve dhe nëse keto pajisje ofertuesi i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje.

Shenim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të paraqesë (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) për pajisjet e deklaruara.

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e pajisjeve të nevojshme mbështetet në nenin 77, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit kriteret e kualifikimit mund të lidhen me aftësinë teknike dhe profesionale dhe autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik të disponojë burimet teknike të nevojshme për zbatimin e kontratës.

Gjithashtu, neni 41, pika 2 dhe pika 4, shkronja “ç”, e VKM-së nr. 285/2021, e ndryshuar, parashikon se kriteret duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura me objektin e kontratës, si dhe lejon kërkimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike që operatorin ka në dispozicion ose që mund t’i vihen në dispozicion për realizimin e kontratës.

Pajisjet e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me proceset që përbëjnë objektin e prokurimit, pasi specifikimet parashikojnë printim me ngjyra dhe bardhë e zi, prerje, plastifikim dhe forma të

ndryshme lidhjeje të materialeve të shtypura. Disponimi i tyre garanton kapacitetin real të operatorit për realizimin në kohë dhe me cilësi të botimeve.

Deklarimi në fazën e ofertimit dhe paraqitja më pas e dokumenteve që provojnë pronësinë ose të drejtën e përdorimit të pajisjeve mbështetet edhe në nenin 26, pikat 2/i dhe 6, të VKM-së nr. 285/2021, që parashikon vetëdeklarimin për mjetet dhe makineritë e nevojshme dhe dorëzimin e dokumenteve provuese nga ofertuesi i kualifikuar i pari.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin **SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001**, mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

*Certifikata **SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001**, ose ekuivalente, kërkohet për të vërtetuar se operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të cilësisë, nëpërmjet të cilit sigurohet organizimi, kontrolli dhe gjurmueshmëria e proceseve të punës gjatë realizimit të kontratës.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim të paktën 4 (katër) punonjës, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: *Kërkesa për disponimin e të paktën 4 (katër) punonjësve mbështetet në nenin 77, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pikat 2 dhe 4/c, të VKM-së nr. 285/2021, i ndryshuar, të cilat parashikojnë mundësinë e kërkit të burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e kontratës, në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e saj.*

Përcaktimi i këtij numri minimal vlerësohet i arsyeshëm për realizimin e shërbimeve të dizajnit, redaktimit, faqosjes dhe printimit. Listëpagesat dhe dokumentacioni shoqëruar shërbejnë si dokumente provuese për plotësimin e këtij kriteri, duke vërtetuar se operatori ekonomik disponon personel aktiv dhe kapacitete reale për kryerjen e shërbimit. Punësimi i tyre të paktën gjatë muajit të fundit të deklaruar garanton gjithashtu se personeli është i integruar në strukturën e operatorit dhe i njohur me standardet dhe procedurat e punës së tij.

Në fazën e ofertimit kriteri përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentet provuese paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, sipas nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, i ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë personel të kualifikuar për realizimin e objektit të kontratës, konkretisht:

- a) të paktën 1 (një) dizajner grafik,
- b) të paktën 1 (një) redaktues,
- c) të paktën 2 (dy) punonjës ndihmës të cilët angazhohen me kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

Për përmbushjen e pikës (a) dhe të pikës (b) të këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë, për secilin prej personave të kërkuar:

- diplomë dhe/ose certifikatë që provon kualifikimin përkatës;
- kontratë pune të vlefshme.

Për përmbushjen e pikës (c) të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë, për secilin prej personave të kërkuar:

- kontratë pune të vlefshme.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pikat 2 dhe 4, shkronjat “b” dhe “c”, të VKM-së nr. 285/2021, i ndryshuar. Neni 41 parashikon që, për kontratat e shërbimeve, kriteret duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe aftësinë zbatuese të kontratës, si dhe lejon kërkimin e personelit kryesor dhe të fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e objektit.*

Kërkesa për 1 dizajner grafik, 1 redaktues dhe 2 punonjës ndihmës lidhet drejtpërdrejt me shërbimet objekt prokurimi, të cilat përfshijnë dizajnimin, redaktimin, faqosjen, printimin dhe proceset përkatëse të përgatitjes së botimeve. Dizajneri grafik është i nevojshëm për përpunimin dhe paraqitjen vizuale të materialeve, redaktuesi për kontrollin dhe përpunimin gjuhësor të përmbajtjes, ndërsa punonjësit ndihmës për realizimin e proceseve operative të shërbimit. Kërkimi i diplomës dhe/ose certifikatës për personelin e specializuar shërben për të provuar kualifikimin profesional, ndërsa kontrata e punës vërteton disponueshmërinë reale të personelit për realizimin e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të kryejë shërbimin, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: *Kërkesa është vendosur me qëllim garantimin e realizimit të shërbimit në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, të cilat përbëjnë kushtet teknike për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Operatori ekonomik, nëpërmjet kësaj deklarate, merr përsipër respektimin e të gjitha kërkesave teknike gjatë realizimit të kontratës, duke garantuar cilësinë dhe përmbushjen e shërbimit sipas përcaktimeve të dokumenteve të tenderit.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar Urdhrit, me nr. 1122/1 Prot., datë 19.05.2026, Autoriteti ka ngritur Komisionin për testimin e tregut, llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike për procedurën me objekt “Dizajn, redaktim gjuhësor dhe printim të botimeve”, për nevojat e Autoritetit.

Në vijim, me Argumentimin nr. 1122/2 Prot., datë 15.06.2026, Autoriteti ka argumentuar specifikimet teknike/termat e referencës, të hartuara mbi bazën e nevojave konkrete për realizimin e shërbimeve të dizajnit, redaktimit gjuhësor, faqosjes dhe printimit të botimeve institucionale dhe materialeve informuese/promovuese.

Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 41, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, duke përcaktuar kërkesat teknike sipas llojit, formatit dhe karakteristikave të secilit botim, me synim garantimin e cilësisë së shërbimit dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.